



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

**KOMUNA E PRISHTINËS  
KRYETARI I KOMUNËS**

14-334/02-0311413/17 më 22. 12. 2017

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, nxjerr këtë:

**URDHËRESË  
PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT TË PRODUKTEVE PIROTEKNIKE**

I.

NDALOHET përdorimi i produkteve piroteknike në vendet e hapura publike, përkatësisht në tregje, rrugë dhe sheshe.

II.

Ndalesa sipas pikës I të kësaj urdhërese vlen për periudhën prej 30 dhjetor 2017 deri më 03 janar 2018.

III.

Personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese do të gjobiten në shumë prej 100 euro.

IV.

Për zbatimin e kësaj urdhërese kujdeset Drejtoria e Inspektionit.

V.

Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.

I'u dorzohet:

- Drejtorisë së Inspektionit;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbim me qytetar.



KRYETARI I KOMUNËS  
Shpend Ahmeti